



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 152/1 Prot.

Tiranë, më 19 . 01 . 2026

V E N D I M

Nr. 16, datë 19 . 01 . 2026

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 19 Regj., datë 15.01.2026, paraqitur nga znj. A. T kundër Ministrisë së Arsimit, Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë dhe Bashkisë Korçë, në të cilën pretendon diskriminimin të tre fëmijëve të saj, nxënës në shkollën 9-vjeçare “Asdreni”, Korçë, për shkak të “gjendjes ekonomike”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, znj. A. T, në mes të tjerash informon se: “Problematika që kam është lidhur me mospërfitimin e bursës në bazë të VKM nr. 511/2022, të ndryshuar, “Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar”, të tre fëmijëve të mi, të cilët frekuentojnë shkollën 9-vjeçare “Asdreni”, Korçë, respektivisht klasën e nëntë, të gjashtë dhe të katërt.

Në muajin tetor kam dërguar dokumentacionin pranë Shkollës. Në muajin dhjetor interesohem vetë pranë institucionit të Bashkisë, pasi nga Shkolla nuk mora asnjë informacion. Specialistja pranë Bashkisë më thotë që arsyeja që nuk mund të jesh përfituese është pasi bashkëshorti jot është në marrëdhënie pune, me pagë minimale neto 37518 lekë.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

Situata ime familjare është e rëndë pasi familja ime përbëhet prej 7 anëtarësh. Nëse paga do të ishte e mjaftueshme, Bashkia s'do të trajtonte familjen tonë me ndihmë ekonomike. Shqetësimin tim ia shpreha vajzës që kontaktova në Bashki dhe po e bëj prezent edhe para KMD-së .”

Subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkak të gjendjes ekonomike nga ana e Bashkisë Korçë dhe përfitimin e bursës për vitin shkollor 2025-2026, për tre fëmijët e saj: M, G dhe M. B, nxënës në shkollën 9-vjeçare “Asdreni”, Korçë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “”Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 7 të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohe të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e

lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues pranë KMD-së, konstatohet se:

- Referuar Certifikatës Familjare, datë 19.12.2025, të Zyrës së Gjendjes Civile 234, të Bashkisë Korçë, rezulton që M³, G⁴, M⁵, D⁶ dhe D⁷ B, janë fëmijët e znj. A. T dhe z. E. B.
- Referuar Vërtetimit datë 19.12.2025, të shkollës 9-vjeçare “Asdreni” Korçë, rezulton që tre fëmijët e znj. A. T: M, G dhe M. B, janë nxënës të kësaj Shkolle, respektivisht në klasën e nëntë, shtatë dhe të katërt.
- Referuar Vërtetimit të Pagës, datë 12.01.2026, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Korçë, rezulton se, z. E. B është i punësuar pranë subjektit G.I.S.A, dhe ka lidhur marrëdhënien e punës me këtë subjekt në datën 19.02.2024, me pagë bruto mujore në shumën 42250 lekë dhe pagë neto mujore në shumën 37518 lekë.
- Referuar Vërtetimit të datës 19.12.2025, të Drejtorisë së Kujdesit Social/Bashkia Korçë, rezulton që, familja e z. E. B (A. T), trajtohet me ndihmë ekonomike në Njësinë Administrative nr. 2, Korçë, në shumën 15.552 lekë.
- Referuar Vërtetimit nr. T14745935, datë 22.12.2025, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë (Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Individin-E-SIG 03/a), vërtetohet se, znj. A. T është përfituese e programit të veçantë për gratë e papuna me tre ose më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç (*Program i cili mundëson pagesën e sigurimeve shoqërore për gratë e papuna me tre ose më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku të paktën njëri prej fëmijëve është nën 5 vjeç dhe kur të ardhurat familjare janë nën 100.000 lekë në muaj. Përkujdesi për fëmijën deri në moshën 5 vjeç do të njihet si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni pleqërie dhe barrëlindjeje⁸*), dhe se, në emrin e saj janë deklaruar e paguar kontributet shoqërore e shëndetësore, të llogaritura mbi pagën prej 40.000 lekësh.
- Znj. T në muajin tetor 2025, ka dorëzuar dokumentacionin përkatës pranë shkollës 9-vjeçare “Asdreni”, Korçë.
- Në muajin dhjetor 2025, ajo ka pohuar se i është komunikuar nga specialistja e Bashkisë se nuk rezulton përfituese e bursës së tre fëmijëve, pasi bashkëshorti i saj është në marrëdhënie pune.

³ E datëlindjes 07.06.2011.

⁴ I datëlindjes 11.10.2013.

⁵ E datëlindjes 20.05.2016.

⁶ E datëlindjes 04.01.2020.

⁷ E datëlindjes 12.12.2025.

⁸ <https://www.sherbimisocial.gov.al/programi-per-grate-e-papuna/>

Znj. T ka pretenduar para KMD-së, se tre fëmijët e saj: M, G dhe M. B, nxënës të shkollës 9-vjeçare “Asdreni”, Korçë, u janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Korçë, lidhur me mospërfshirjen e tyre në listën e përfituesve të bursës, me fondet e Bashkisë, sipas përcaktimeve të pikës 2.1/c), të VKM-së me nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.

Pika 2.1/c), e VKM-së sipërcituar, përcakton se:

“2. Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kritereve, si më poshtë vijon:

2.1 Kriteri ekonomik:

..... c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.”

Në Pasqyrën nr. 1, “Kushtet ekonomike të nxënësit për dhënien e bursës”, (ndryshuar me Vendimin nr. 511, datë 27.07.2022), specifikohet si më poshtë vijon:

Nr.	Përbërja familjare	Përfitojnë bursa	Përfitojnë gjysmë bursa
	Për qytetin	Me të ardhura mujore, lek/frymë	Me të ardhura mujore, lek/frymë
1	Për familjet me 2 persona	deri 4500	4500 - 5000
2	Për familjet me 3 persona	deri 4200	4200 - 4800
3	Për familjet me 4 persona	deri 4100	4100 - 4600
4	Për familjet me 5 persona	deri 4000	4000 - 4500
5	Për familjet me 6 persona	deri 3800	3800 - 4300
6	Për familjet me 7 persona	deri 3500	3500 - 4200
7	Për familjet me 8 persona	deri 3200	3200 - 4000

Në analizë të akteve sa më sipër, rezulton se, të ardhurat mujore të familjes B (të znj. T), konsistojnë nga të ardhurat e përfituara nga paga e z. B (paga neto 37518 lekë) dhe nga të ardhurat e përfituara nga ndihma ekonomike e akorduar nga Bashkia Korçë (15552 lekë). Pra, gjithsej në shumën prej 53070 lekësh (37518 + 15552 = 53070 lekë).

Familja përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarësh dhe, nisur nga të ardhurat familjare, rezulton që të ardhurat mujore për frymë janë në shumën prej 7581 lekësh (53070:7=7581).

Referuar tabelës së mësipërme, familja e znj. T, klasifikohet tek numri rendor 6, i Paqyrës Nr.1, ku përcaktohet se, për familjet me 7 (shtatë) persona, siç është rasti i ankuses, kriteri për përfitimin e bursës së plotë, është që të ardhurat mujore për frymë duhet të jenë deri në 3500 lekë, ndërsa, kriteri për përfitimin e gjysmë bursës, është që të ardhurat mujore për frymë duhet të jenë nga 3500 - 4200 lekë.

Ndërkaq, nga këqyrja e analiza e dokumentacionit të depozituar pranë KMD-së, rezulton që të ardhurat mujore për frymë, për familjen e znj. T janë në shumën prej 7581 lekësh, pra afërsisht sa dyfishi i të ardhurave mujore për frymë, të përcaktuara për përfitimin e bursës së

plotë dhe gjysmë bursës, në mospërputhje me kriteret e përcaktuara si kualifikuese sipas pikës 2.1/c), të VKM-së me nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.

Përmbushja e kërkesave specifike të VKM-së sipërcituar është kriter paraprak dhe detyrim për t’u plotësuar nga aplikantët (përfshirë dhe znj. T në rastin konkret) për përfitimin e bursës. Në këtë kontekst, Komisioneri vëren se, pretendimi i znj. T për diskriminim ndaj fëmijëve të saj lidhur me mospërfitimin e bursës, bazuar në kriterin ekonomik, sipas përcaktimit të pikës 2.1/c), është haptazi i pabazuar, pasi mospërmbushja e tij është arsye e ligjshme dhe e justifikuar nga ana e Bashkisë, për mos kualifikimin e aplikantes si përfituese.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse:ç) është haptazi e pabazuar.....”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁹.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 19 Regj., datë 15.01.2026, të shtetases A. T, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁹ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 239/2023, Vendimin nr. 165/2025 dhe Vendimin nr. 186/2025, të KMD-së.